

- 2 Kushte dhe paga skandaloze** Përmirësimet vetëm falë intervenimit të Unia
- 3 Varfëria përkeqëson jetën** Frika nga pasojat detyron njerëzit të mos kërkojnë ndihmë
- 4 Digjitalizimi i informacioneve** Abonohu «Horizonte» për informacione në gjuhën shqipe

Nr. 1 | Shkurt 2024 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Tani do shkoj të votoj

# Migrantët për një pension më të mirë!

**«Ne punëtorët e ndërtimtarisë bëjmë punë të rëndë. Të punosh më gjatë nuk është zgjedhje. Jo sulmit ndaj pensionimit me moshën 60 vjeçare.»**  
Xhafer Sejdiu, punëtor i ndërtimtarisë

**«Gjithçka është shtrenjtuar shumë. Nëse duam sado pak siguri në pleqëri, duhet të rrisim pensionet e AHV-së.»**  
Saranda Xhinovci, specialiste pastrimi

**Mosha e pensionimit me 67 më 3 mars** **JO**

**AHV x13 më 3 mars** **PO**

Prononcimet e dy bashkatdhetarëve punëmarrës në lidhje me votimet e 3 marsit 2024 për dy nismat në fjalë.

Me 3 mars 2024 ne do të kemi mundësinë që të vendosim për të ardhmen e pensioneve të pleqërisë. Do të votohen dy koncepte: pensione më të larta për pensionistët e tanishëm dhe të ardhshëm (AHV/AVS 13) ose të punohet më gjatë (iniciativa pensionale). Iniciativa e sindikatave «Për një jetë më të mirë në pleqëri (nisma për një pension të 13 të AHV/AVS)» donë që të gjithë pensionistët e pensionistët të marrin një pension të trembëdhjetë. Kjo do të thotë një rritje e pensionit të AHV/AVS për 8.3 përqind. Dhe kjo është urgjentisht e nevojshme.

Marek Wieruszewski

Varfëria në pleqëri në Zvicër mjerisht është tepër e përhapur. Anketa përfaqësuese tregon se 200 000 të moshuar jetojnë me të ardhura nën kufirin e varfërisë. Të ardhurat mujore të 100 000 të moshuarve tjerë qëndrojnë vetëm pak mbi kufirin e varfërisë. Kush është i prekur? Siç ndodh shpesh, kryesisht gratë dhe migrantët. Bie në sy se migrantët e migrantët përgjithësisht shëndetësor, pensionistët deri në fund të 2024-ës do të humbasin një pension të tërë mujor. Të gjithë të prekurit qysh tani e vërejnë këtë. Pensioni me-

satar i AHV/AVS është pak më pak se 1800 franga në muaj. Mandati kushtetues për mbulimin e kostos së jetesës gjithnjë e më pak po e përmbush pensioni AHV/AVS. Kush është i varfër ka jetëgjatësi më të shkurtër.

#### Parashikime të mira

Kjo është edhe arsyeja pse anketat e para të Tamedias për votimin janë inkurajuese. 71 përqind duan të aprojnë nismën AHV /AVS x13. Kjo do të thotë se nisma aktualisht gëzon mbështetjen e shumicës në të gjitha shtresat e popullsisë dhe madje edhe në qarqet tradicionalisht ekonomikisht liberale. Për Presidentin e Bashkimit të Sindikatave të Zvicrës (SGB/USS) dhe politikanin e PS-së Pierre-Yves Maillard, është e qartë pse kërkesa është pritur kaq mirë nga popullata: «Pensioni i 13 i AHV/AVS është zgjid-

hja më e mirë dhe më e shpejtë, për të përmirësuar pensionet.»

#### Të ndihmojnë edhe ne për përmirësimin e pensioneve

Shumë njerëz me sfond migracioni kanë nënshtetësi zvicerane dhe lejojnë të votojnë. Është e rëndësishme që edhe ata të përdorin të drejtën dhe të votojnë. Por edhe ne që nuk kemi të drejtë të votojmë mund të angazhohemi për suksesin e nismës. Le të flasim me miqtë dhe kolegët tanë me të drejtë vote dhe t'i bindim për përfitimin e rritjes së pensionit për të gjithë. Në mënyrë që nisma AHV/AVS 13 të kalojë, ne kemi nevojë për pjesëmarrjen tonë të përkushtuar dhe të fortë.

E dyta për të cilën do të votojmë është nisma e pensioneve të Rinjve liberalë. Ata duan të rrisin moshën e daljes në

pension. Në hapin e parë, duan që të rritet në 66 vjet. Pas kësaj, mosha e daljes në pension duhet të rritet me 0,8 muaj për çdo muaj jetëgjatësi shtesë. Emri i saj në fletëvotim është: «Për një pensionim të sigurt dhe të qëndrueshëm pleqërie (iniciativa pensionale)». Ideja e të Rinjve liberalë për të rritur moshën e daljes në pension prek edhe një herë njerëzit që tashmë janë në një pozitë të pasigurt. Të pasurit mund t'i lejojnë vetit shkuarjen para kohe në pension. Me rritjen e moshës referuese të AHV/AVS, vetëm të pasurit mund përballojnë pensionimin e parakohshëm. Të tjerëve, pavarësisht nga gjendja e tyre shëndetësore, do t'u duhej të punonin edhe më gjatë. Kjo iniciativë duhet luftuar me forcë.

Më shumë informacion rreth votimit: [unia.ch/de/kampagnen/ahv-x13](http://unia.ch/de/kampagnen/ahv-x13)

## Editorial



### «Tani do shkoj të votoj»

Me 3 mars ne do të votojmë për marrjen e një pensioni të 13 të AHV/AVS-së. Ne kemi mundësinë që me një Po në kutinë e votimit të përmirësojmë jetën e shumë pensionistëve të tanishëm dhe të ardhshëm. Dhe ju lutemi votoji!

Unë dëgjoj vazhdimisht njerëzit duke thënë, po, do ta bëja, por nuk e di se si bëhet kjo. E mira është që: Zgjedhjet dhe votimi nuk është gjë e lindur, por ato mund të mësohen. Ne kemi përgatitur për ju një udhëzuar në faqen 3.

Një histori timen dua ta ndajë me ju. Para disa vitesh mblidhnim nënshkrime për një iniciativë të AHV/AVS. Kolegu im nga malësia e Bernës, që këtu po e quaj Urs, dhe unë duhej të mblidhnim në stacion të trenit. Ne u ndamë. Pas dy orësh u takuam për një pushim kafeje. Uni i tregova Ursit se sa nënshkrime kam mund ti grumbullojë. Ursi u përgjigj shkurt: «Unë kam zero nënshkrime. Unë nuk e di si bëhet kjo, tha ai shumë hapur. Unë isha i befasuar, se Ursi ishte zviceran, politikisht i interesuar dhe aktiv. Pastaj kemi ushtruar. Ursi më pas kishte sukses dhe ishte shumë i kënaqur.

Kjo episod ma bërë të qartë: Ushtrimi i të drejtave politike nuk është gjë e lindur, por sikur edhe gjërat tjera, duket të mësohet dhe të ushtrohet. Kjo ma kujtoj edhe herën e parë të votimit pas natyralizimit tim, kur unë nuk isha i sigurt, se si votohet me shkrim përmes postës. Unë thjesht i kam pyetur njerëzit, që këtë e kanë ditur mirë. Dhe nuk ishte edhe aq e vështirë. Tani unë marr pjesë rregullisht në zgjedhje dhe votime dhe e shijoj privilegjin për të folur dhe për bashkëvendosur politikisht. Dhe unë për pensionit e 13 të AHV/AVS do të them Po.

Hilmi Gashi



## News

## Përparim për personelin e sigurimit: Zgjatja e KKP dhe paga minimale më të larta

Unia dhe partnerë të tjerë socialë negociuan me sukses me punëdhënësit në sektorin e sigurisë dhjetorin e kaluar. Vlefshmëria e përgjithshme e KKP-së do të zgjatet edhe për një vit dhe paga minimale do të rritet deri në 1.8 për qind. Andaj partnerët socialë i bëjnë thirrje urgjente sektorit publik që gjatë dhënies së kontratave të ketë parasysh jo vetëm çmimin, por edhe cilësinë dhe kushtet e punës. Kjo qasje parandalon shkeljen e çmimeve në kurriz të punëmarrësve.

## Pagat në sektorin e skelendërimit po rriten

Ndërkohë që negociatat për ripërtëritjen e KKP-së do të fillojnë këtë vit, sindikatat tashmë kanë realizuar një rritje të pagave minimale qysh vitin e kaluar nga 105 në 150 franga në muaj dhe një rritje prej 1.5 për qind të pagave minimale. Unia ka edhe kërkesa të tjera në tavolinë: masa më të mira për parandalimin e aksidenteve, një reduktim të orarit të punës me rreth 100 orë në vit në një ditë mesatare 8-orëshe, që pushimi 9-orësh të llogaritet si kohë pune (që korrespondon me rreth 60 orë në vit.), një kufizim për punën të shtunave, një garanci që të gjithë punonjësit mund të marrin të paktën tre javë pushime të pushkëputura gjatë verës dhe mbrojtje reale për punonjësit e moshuar përmes periudhave më të gjata të njoftim-largimit nga puna.

## Shitoret në pikat e karburanteve: A ke nevojë për një rritje page?

Unia donë të dijë se çfarë nevojash dhe dëshira pagash kanë punonjësit në pikat e karburantit. Për këtë qëllim, ajo ka nisur një anketë për të kuptuar nëse punonjësit mbështesin rinegociimin e pagës minimale me një rritje prej 300 frangash në muaj. Sa më shumë punonjës të prekur të marrin pjesë në anketë, aq më mirë sindikata mund të negociojë me punëdhënësit. Në fund të shkurtit, partnerët socialë do të takohen për një shkëmbim fillestar. Anketa në ueb faqen e Unia është dispozicion në gjermanisht, frëngjisht dhe italisht: <https://www.unia.ch/de/arbeitswelt/von-a-z/dienstleistungsberufe/tankstellenshops/umfrage-lohnerhoehung>.



## Bilanci vjetor i Migros-it: Fitim i lartë, por presion ndaj stafit sa vjen e rritet

Migros Group vazhdon të rrisë ndjeshëm fitimet, por ndaj stafit të vet po ushtron gjithnjë e më shumë presion. Këto rezultate të mira biznesore duhet të çojnë në paga më të larta dhe rritje të numrit të personelit. Ndërkohë që Migros Group deklaroi fitime të larta, presioni ndaj punonjësve po rritet. Migrosi refuzon dialogun. Unia kërkon me forcë që rezultatet pozitive të biznesit jo vetëm të zbrazen në arkat e saj, por gjithashtu që edhe punonjësit të përfitojnë rritja e fitimit.



## Suksese në kantieret e Bernës kundër dumpingut në paga, Kushte të pasigurta pune

Kushtet e paqëndrueshme në një kantier ndërtimi në Bernë: Për javë të tëra, punëtorëve të ndërtimtarisë të rekrutuar në Hungari u është dashur të hanë, të flenë dhe të mbijetojnë në kantier – midis mbeturinave dhe veglave të punës. Sikur kjo të mos mjaftonte. Punonjësit janë mashtruar edhe për pagat e tyre: Në vend se të 27 frangave janë paguar me 15 euro. Vetëm pas një aksioni protestues para kantierit u paguan pagat korrekte.

Emine Sariaslan

Gjatë një vizite në kantierin e ndërtimit, punonjësit e Unia zbuluan dhe i bënë të ditura kushtet e pasigurta të punës Disa punëtorë nga Hungaria jo vetëm që vuajtën në vendin e punës, por aty edhe u është dashur të mbijetonin: në dyshekë të zhveshur në dysheme, me një tualet të ndotur pranë një ngrohësi uji të improvizuar dhe një dushi të improvizuar mes mureve gjysmë të grisura. Dhe kjo gjendje është që nga mesi i nëntorit 2023. Sindikata Unia ka reaguar menjëherë, duke i akomoduar urgjentisht pesë punëtorë në një hotel, për t'i nxjerr ata jashtë kushteve jo higjienike dhe poshtëruese dhe për t'u dhënë atyre mundësi strehim me dinjitet njerëzor.

### Të mashtruar në paga

Hetimet e mëtejshme nga Unia kanë treguar se punëtorët janë mashtruar edhe përkitazi me paga e tyre. Paga minimale në sektorin e ndërtimtarisë është rreth 27 franga në orë. Kompania «Matszbo Team KFT», me seli në Budapest, e cila dërgoi punëmarrësit, u premtoi atyre vetëm 15 euro në orë. Por punëtorët nuk e morën as edhe këtë pagë të shkelur. Gjithashtu të papaguara ishin shpenzimet si dhe shtesat për akomodim dhe ushqim.

### Ndërprerja e punës rezultoi me pagesë shtesë prej 36 305 frangash

Bashkë me punëtorët, Unia organizoi një protestë para kantierit, e cila u kthye në një ndërprerje pune. Kjo bëri që përgjegjësit «Roga Generalunternehmung GmbH» me qendër në kantonin Schwyz të ndërgjegjësuar për ankesat – dhe i shtyu ata të paguanin menjëherë shumat e papaguara. Punëtorët tashmë kanë marrë 36 305 franga që u takonin deri më tani.



Pagat skandaloze. Punëtorët marrin pagat korrekte falë intervenimit të Unia

### Zgjerimi dhe jo zvogëlimi i masave shoqëruese

Ndërprerja e punës në raste flagrante të dumpingut të pagave është efektive dhe mund t'i japë fund shpejt situatave të tilla të padenja të punës dhe strehimit. Nevojitet të ketë një zgjerim të synuar të masave shoqëruese mbrojtëse me rregulloret përkatëse në nivel kombëtar. Rasti në fjalë tregon se shpenzimet e bëra në Zvicër duhet të paguhet edhe nga kompanitë dërguese. Përndryshe, punonjësit – thënë qartë – do të përfundojnë në pisllek. Ky rast tregon se masat shoqëruese mbrojtëse duhet të zgjerohen dhe jo të zvogëlohen.

## Protesta e suksesshme e punonjësve të logjistikës

# CEVA Logistics i rritë rrogat

Punonjësit e «CEVA Logistics» kanë kërkuar me muaj të plotë bisedime për ngritjen e pagave dhe kushte më të mira të punës. Tash CEVA bën lëshimet e para për pagat. Në qendrën e logjistikës, rreth 500 njerëz – shumica dërguese e tyre janë gra – përpunojnë pakot me mallra të kthyera për Zalando me paga shumë të ulëta.

Hilmi Gashi

Trysnia e punonjësve të qendrës së logjistikës «CEVA Logistics» në Neuendorf (SO) është e frytshme dhe jep rezultatet e para. Ndërmarrja ka paralajmëruar disa përmirësime: futjen e pagë së 13-të mujore, rritje të përgjithshme të pagave për punonjësit me kontratë të përhershme dhe për punonjësit e përkohshëm, një rritje graduale (shkallëzore) të pushimeve vjetore në pesë javë (një ditë më shumë në vitin 2024). Gjithashtu është premtuar edhe punësimi i personelit të përhershëm. Tash për tash, më shumë se gjysma e të punësuarve punojnë me kontrata të përkohshëm (temporer).

### Pagat e ulëta, kushte të këqija të punës.

Këto të drejta vijjnë pasi punëtorët kanë kërkuar me muaj të tërë vazhdimisht negociata për rritjen e pagave dhe përmirësimin e kushteve të punës. Shumica e rreth 250–300 punëtorëve, kryesisht gra, fitojnë më pak se 3500 franga në muaj për përpunimin e pakove të kthyera të Zalando. Përveç kësaj, presioni në punë është jashtëzakonisht i lartë. Në shtator, synimet ose objektivat e produktivitetit (numri i paketave për t'u përpunuar) u rritën përsëri për 5 për qind – ndërsa pagat mbetën të njëjta.

### Angazhimi i punëtorëve po ndikon

Në vjeshtën e vitit 2023, punëtorët e turneve të mëngjesit organizuan një protestë për të theksuar kërkesat e tyre. Kur kërcënuan me një grevë paralajmëruese, CEVA më në fund bëri lëshimet e para për të rritur pagat skandaloze të ulëta. Unia i bën thirrje kompanisë që tani të ulët në tryezë me përfaqësuesit e punëtorëve të saj për të gjetur zgjidhje të përbashkëta për përmirësimin e kushteve të punës në të ardhmen. Çështje të rëndësishme dhe shumë nga kërkesat e fuqisë punëtore mbeten pa përgjigje deri më sot.



Trysnia qon në rezultate. Tash përmirësohen pagat.



## Ministri i Ekonomisë Parmelin i lë punonjësit në baltë

## SAKANDALOZE:

Qeveria federale refuzon mbrojtjen e largimit nga puna – sindikatat bëjnë thirrje për iniciativë

Anne-Sophie Zbinden, Redaktore kryesore në Work

Ishte një dhuratë me helm që Qeveria federale u dha rrogëtarëve në Zvicër në mbledhjen e saj të fundit para Krishtlindjeve: Mbrojtja e largimit nga puna nuk do të duhej të përshtatej vetëm me standardet minimale ndërkombëtare. Zyrtarisht thuhet se Ministri i Ekonomisë Guy Parmelin (SVP/UDS) thjesht ka «pezulluar përko-hësisht» ndërmjetësimin. Por në fakt kjo domethënë: Ndërmjetësimi ka dështuar.

Kryetarja e Unia Vania Alleva thotë: «Dështimi ndërlidhet me qëndrimin e papër-

gjegjshëm të shoqatës së punëdhënësve dhe mungesës së guximit të Qeverisë federale. Është skandalozë që mbrojtjen e punonjësve ndaj largimeve të padrejta nga puna nuk duan ta ngrënë as në minimumin e njohur ndërkombëtarisht». Kjo është arsyeja pse sindikatat do të ndërmarrin shpejt një nismë popullore.

Për më shumë se njëzet vjet, punëdhënësit kanë refuzuar me kokëfortësi të përmirësojnë mungesën e mbrojtjes për punonjësit aktivë në sindikata. Zvicra në fakt ka

ratifikuar Konventën përkatëse Nr. 98 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës – ONP (ILO), por ajo nuk e zbaton atë. Kjo nuk mund të zgjat pafundësisht. Kjo është arsyeja pse ILO e vendosi Zvicrën në një listë të zezë në vitin 2019, pasi që ajo nuk mbron në mënyrë adekuate të drejtat e punëtorëve.

Pikërisht: Zvicra u hoq nga lista e zezë e ONP-së vetëm se dha pëlqimin për ndërmjetësim. Mbetet të shihet nëse Zvicra do të futet sërish në listën e zezë.



Nuk lejohet të na mbyllni gojën. Mbrojtje të aktivistëve sindikal.

## Të votosh DO TË THOTË TË BASHKËVENDOSËSH!

Me 3 mars 2024 ne do të votojmë për dy nisma pensionale. Nisma popullore «Për një jetë më të mirë në pleqëri (Iniciativa për një pension të 13 të AHV/AVS)» donë që të gjitha pensionistët e pensionistët të marrin një pension të 13-të. Kësaj ne nga Unia dhe struktura e Migracionit të Unia i themi qartë PO.

Nisma e të Rinjve liberal «Për pensione të sigurta e të qëndrueshme (iniciativa e pensionimit)» donë të rrisë moshën e daljes në pension. Ne nga Unia dhe struktura e Migracionit të Unia i themi qartë JO zu kësaj nisme të rrezikshme.

Është shumë me rëndësi: Të gjithë që kanë të drejtë vote, duhet gjithsesi të votojnë. Qoftë në kutitë e votimit me 3 mars 2024, ose përmes postës

## Këtu janë udhëzimet për votim me postë.

Procedura e saktë e votimit ndryshon nga kantoni në kanton. Në thelb, votimi i drejtë e korrekt është si më poshtë:

Zarfi i pranuar për votim hapet me kujdes dhe siç tregohet këtu. Luteni të mos e grisni as të mos e prisni.	Shkruani Po ose vendosni një plus në katrorin për PO në fletën e votimit për «AHVx13». Ndërsa për «iniciativën e pensioneve». Një JO	Fletët e votimit i vendosni në zarfin më të vogël të votimit dhe mbylleni zarfin.	Në shkruajeni Fletë-kartën e të drejtës së votimit	Vendosni zarfin e votimit dhe fletë-kartën e të drejtës së votimit në zarfin e pranuar. Adresa e Komunës duhet të jetë e dukshme.	Dërgojeni zarfin e pranuar të votimit me postë deri më 27 shkurt ose të hidheni në kutinë postare të administratës komunale deri më 1 mars.

Si duhet të votoni? Një udhëzim.

## Intervistë



## Kur të varfëritë nuk tërheqin kontributet nga asistencë sociale

Sistemi social ka për qëllim të mbështes njerëzit e rrezikuar nga varfëria dhe t'u mundësojë një jetë në dinjitet. Por, në Zvicër, megjithatë, një çerek i njerëzve të cilët do të kishin nevojë për këtë ndihmë, nuk e marrin atë. Horizonte ka biseduar me profesorin e shkollës së lartë të Bernës, Olivier Hymbelin mbi arsyet dhe pasojat.

## Profesor Hymbelin, kush janë këta njerëz, të cilët nuk tërheqin ndihmat sociale?

Njerëz të ndryshëm, por mbi të gjitha janë të ashtuquajtur «punonjësit e varfër». Ata punojnë, por pagat e tyre nuk i mbulojnë shpenzimet për mbijetesë. Në mesin e tyre ka edhe migrant. Për qytetin e Bazelit, p.sh. ne e dimë: migrantët kanë rrezik më të lartë të varfërisë, se sa zvicëranët. Në të njëjtën kohë, ata kanë disi më pak gjasa për të kërkuar ndihmë sociale.

## Pse ndodhë kjo?

Arsyet janë të ndryshme. Për migrantët pengesë janë gjuha dhe njohuritë e sistemit social. Informacionet zakonisht janë në gjuhë zyrtare dhe shumë formular janë të ndërlikuar, edhe po të njohësh gjuhën. Të prekurit shpesh tregojnë se ndjejnë turp dhe kanë frikë nga humbja e pavarësisë. Shumë njerëz nuk e kanë lehtë të kërkojnë ndihmë prej shtetit. Edhe detyrimet ligjore luajnë rol: p.sh. detyrimi për kthimin e ndihmës, dhe kjo i bie si një lloj shlyerje të borgjit. Migrantët gjithashtu kanë frikë nga pasojat, që mund të lindin nga Ligji mbi të huajt, i cili ka shkaktuar shumë pasiguri. Pasojat e mundshme frikësojnë vetvetiu.

## A luan rol edhe diskursi mediatik?

Po, si diskutohet varfëria në media, si përmenden të prekurit apo grupe të tëra në diskursin publik, ka një ndikim. Këtë edhe e duan grupe të caktuara politike.

Mos marrja e përfitimeve sociale a nuk bie ndesh me këtë diskurs?

Mund të themi që po. Ka shumë më shumë njerëz që jetojnë nën kufirin e varfërisë pa ndihmë sociale. Dhe ka shumë pak raste të të cilët diçka mund të ketë shkuar keq. Niveli i kontrollit që të mos ndodhin keqpërdorimet në një anë dhe rastet e pakta të abuzimit në vit, qëndrojnë në kundërshtim, edhe duke marrë parasysh faktin, se më tepër njerëz jetojnë nën pragun e varfërisë dhe nuk kërkojnë asnjë mbështetje.

## Çfarë bëjnë të prekurit nëse nuk marrin përfitime sociale?

Disa kërkojnë mbështetje nga organizata bamirëse, nga familja ose miqtë. Kjo mund të jetë problematike sepse disa njerëz futen në borxhe. Shumë përshtaten me një jetë më pak. Nuk shkojnë te mjeku apo dentisti dhe tërhiqen nga jeta shoqërore dhe jetojnë të vetmuar. Dhe kështu një situatë varfërie mund të bëhet kronike: shëndeti vazhdimisht përkeqësohet, grumbullohen problemet që ndoshta mund të ishin parandaluar me këshillime me kohë.

## Çfarë pasojash sociale mund të ketë mos marrja e ndihmave?

Para së gjithash, ajo dobëson kohezionin social. Dhe mund të bëhet problem për shoqërinë. Për shembull, nëse nuk shkon te mjeku, mund të krijohet një situatë emergjente. Kjo shkakton shpenzime shtesë që duhet të përballohen nga shoqëria e gjerë. Nëse fëmijët jetojnë në familje, ekziston edhe rreziku që ata të mos marrin mbështetje të përshtatshme dhe të trashëgojnë situatën e varfërisë. Të prekurit duhet të këshillohen sa më shpejt që të jetë e mundur për të gjetur një rrugëdalje nga urgjenca. Por disa të prekur kërkojnë ndihmë vetëm kur situata është përkeqësuar. Kjo është arsyeja pse do të ishte e rëndësishme të shkojnë më herët në zyrën e mirëqenies sociale dhe të paktën të marrin informacion rreth mundësive të mbështetjes.

Marília Mendes



## Ju pyesni, Unia përgjigjet

### Përlogaritja gabimisht: A duhet tani që unë të paguaj për gabimin?

Ka disa muaj që unë marr pagesën e papunësisë. Sot mora një vendim nga Arka e sigurimit të papunësisë ku thuhet që më duhet të kthej mbi 1000 franga. Ishte bënë një gabim gjatë përlogaritjes së të ardhurave të mia të siguruar. Arka e sigurimit të papunësisë këmbëngul në kthimin e tyre. Kjo nuk është e drejtë, unë nuk jam me faj, ata nuk kanë punuar siç duhet. A duhet unë megjithatë të kthej paratë?

Natasa Jevdenic: Po, mjerisht. Arka e sigurimit të papunësisë është e obliguar që të korrigjojë gabimet e zbuluara. Ju nuk jeni fajtor për gabimin, kjo qëndron, ishte thjesht një gabim i arkës. Duke mbi llogaritje fitimet tuaja të siguruar, ju keni marrë më shumë para. Këtu kemi të bëjmë me «përfitimet e marra në mënyrë të parregullt», që nuk ka të bëjë me faktin se kush ishte fajtor për gabimin, por vetëm me faktin se kompensimi i paguar nuk përputhet me përfitimet ligjore. Prandaj, kërkesa për kthim, nga pikëpamja ligjore, është e drejtë. Arka e sigurimit të papunësisë është e detyruar të bëjë kërkesën dhe ju duhet të rimbursoni shumën.

### Fitimet anësore shtesë: A lejohet që arka të kërkojë kthimi i parave?

Unë para 3 vitesh kam qenë i papunë dhe kam marrë përfitim. Në të njëjtën kohë, nga zyra për punë të përkohshme kisha disa detyra angazhimi për punë pastrimi mbrëmjeve dhe fundjavave. Arka e sigurimit të papunësisë tani po më kërkon t'u kthej para, sepse nuk i kam deklaruar këto detyra angazhimi në pastrim. Ato u zhvilluan jashtë orarit tim normal të punës dhe unë gjithmonë i dorëzoja të gjitha me ndërgjegje. A mund tani Arka e sigurimit të papunësisë të kërkojë kthimin e parave?



EDUKIMI: RAV/ORP bën përfitim kur bëhet fjalë për kujdesin ndaj fëmijëve. (Foto: Adobe Stock)

Natasa Jevdenic: Po. Si pjesë e ligjit federal për masat për të luftuar punën e padeklaruar, zyra qendrore e kompensimit krahason pagesat e ndihmës ditore nga sigurimi i papunësisë me hyrjet në llogaritë individuale (hyrjet në LLI).

Në rastet e përputhshmërisë informohet sigurimi i papunësisë dhe rastet shqyrtohen në detaje. Prandaj, veprimet e Arkës së papunësisë konsiderohen në rregull. Kur bëhet fjalë për punë e pastrimit, duhet bërë një dallim nëse i keni pasur këto para se të mbeten të papunë apo jo. Çdo punë e bërë gjatë marrjes së përfitimet të papunësisë llogaritet si të ardhura të ndërmjetme. Nëse keni filluar të punoni pasi keni mbetur i papunë, do t'ju duhej ta raportoni atë si të ardhura të ndërmjetme. Nëse i keni pasur këto punë pastrimi më parë, jashtë orarit tuaj normal të punës, këto janë punë fitimi anësor. Nëse keni punuar më shumë kur ishit i papunë, këto duhet të llogaritet si të ardhura të ndërmjetme, përndryshe jo.

(Work, 1.12.23)

### Kujdesi për fëmijët: A mund të aplikoj për para nga RAV/ORP?

Sigurimi i invaliditetit i ka dhënë burrit tim një pension të pjesshëm. Ky pension nuk mjafton për të ushqyer familjen tonë prej katër anëtarësh: që nga lindja e fëmijës së parë, unë jam kujdesur për dy fëmijët (një dhe tre vjeç). Kam kërkuar punë, deri tani pa sukses. Pasi kemi para të pamjaftueshme, u lajmërova edhe në entin social të Komunës. Punonjësja sociale më këshilloi të regjistrohesh në RAV/ORP në mënyrë që të mund të merrja kompensimin e papunësisë ndërsa jam në kërkim të vendit të punës. A kam të drejtë për kompensim papunësie edhe pse nuk kam punuar që nga viti 2020?

Marina Wyss: Po, me kusht që të plotësohen të gjitha kërkesat dhe në veçanti periudhat e kontributit. Kur regjistrohesh në RAV/ORP, hapet një periudhë e ashtuquajtur kornizë, brenda së cilës paguhen kontributet për një periudhë të caktuar kohore (periudhat e kontributit). Sipas rregullit, duhet të keni punuar për 12 muaj brenda dy viteve të fundit për të pasur të drejtën e kompensimit të papunësisë. Ligji parashikon një përjashtim për personat e siguruar që i janë përkushtuar rritjes së fëmijëve nën moshën dhjetë vjeç: periudhat e kontributit duhet të kenë përfunduar brenda katër viteve të fundit në vend të dy viteve. Pas çdo lindje fëmije tjetër shtesë zgjatet kjo periudhë kornizë. Në rastin tuaj është gjithashtu përcaktuese që burri juaj është bërë invalid. Madje, ligji parashikon edhe përjashtimin nga periudhat e kontributeve në raste të tilla.

(Work, 15.12.23)

## «Horizonte» digjitalizohet. Abonohu tash falas!

Hilmi Gashi

«Horizonte» u themelua për të informuar koleget e kolegët tanë me sfond migracioni në gjuhën e tyre të kuptueshme rreth zhvillimeve rreth migracionit dhe politikën e sindikatave. Në cilësi të mirë, ne sjellim në formë të shtypur si gazetë në letër shtatë herë në vit në shqip kontributet gjuhësore mbi KKP-të, pagat, nismat, intervistat, portretet, agjendat për ngjarjet. Përveç kësaj, ne u përgjigjemi pyetjeve të anëtarëve tanë në çdo çështje.

Si gazetë shumëgjuhëshe e sindikatës Unia, «Horizonte» iu është bashkangjitur gazetave të Unia si Work (në gjermanisht), L'Événement (në frëngjisht) dhe Area (në italisht). Kjo bashkëngjitje në brendësi të këtyre gazetave më të mëdha ndonjëherë e bën të vështirë «zbulimin» e gazetës Horizonte. Nëse dikush nuk lexon një nga gazetave qendrore të Unia dhe e lenë anash pa hapur atë, «Horizonte» nuk zbulohet fare.

### Numri 3 do të jetë në formë digjitale

Ndërkohë, mundësitë për marrjen e informacionit janë bërë më të ndërlukuara. Digjitalizimi dhe përdorimi i gjerë i platformave të mediave sociale si Facebook, Instagram, X (ish Twitter) hapin

mundësi të reja për të informuar anëtarët tanë dhe anëtarët potencialë. Ky zhvillim është gjithashtu një mundësi për Unia dhe «Horizonte» për të arritur më shumë njerëz me informacionin tonë shumëgjuhësh dhe gjithashtu për të shpërndarë këto informacione nëpërmjet mediave sociale. Nga viti 2024, «Horizonte» do të publikohen katër herë në formë letre (gazete të shtypur) dhe tri herë në mënyrë digjitale. Numri i parë në formë digjitale do të del me 11 mars 2024. Nga viti 2025 e tutje, «Horizonte» pritet të jetë vetëm në formën digjitale.

Për t'u siguruar që jeni gjithmonë të informuar se kur numri më i ri i «Horizonte», ne kemi nevojë për adresën tuaj aktuale të postës elektronike (E-Mail) ose numrin tuaj të telefonit celular. Ju lutemi plotësoni formularin e duhur për t'u abonuar në «Horizonte» pa pagesë. Të dhënat do të trajtohen në mënyrë besuar.

Abono «Horizonte»: <https://www.unia.ch/sq/anetaret/horizonte-digital>



## Tubime informuese mbi votimet federale të 3 marsit 2024

# Po pensionit të 13 të AHV/AVS! – Jo shtyrjes së moshës së pensionimit!

Në fillim të shkurtit, pikërisht një muaj para votimeve të rëndësishme të 3 marsit 2024, sindikalistët shqiptaro-zviceran të regjionit Cyrih-Shafhauzen në mbështetje të fushatës së sindikatave për një pension të 13 të pleqërisë AHV/AVS, startuan ndër të parët me tubime informuese dhe mobilizuese në gjuhën shqipe mbi këto dy nisma të rëndësishme e jetike mbi të ardhmen për të gjithë pensionistët e tanishëm dhe të ardhshëm.

Tubimi i parë u zhvillua të premten me 2 shkurt në lokalet e sindikatës Unia të Cyrihut, ndërsa një ditë më pas, me 3 shkurt në lokalet e Shoqatës Kulturore Shqiptare «Bashkimi» në Uster, po në Kantonin e Cyrihut. Në të dyja takimet morën pjesë rreth 50 bashkatdhetarë burra e gra.

### Ndikimi ynë mund të jetë përcaktues: Të shfrytëzohet e drejta e votës!

Manifestimin në Cyrih e hapi sekretarja e re e sindikatës Unia Alma Morina, e cila fillimisht ia dha fjalën Xhafer Sejdiut, kryetarit të Unia për regjionin Cyrih-Shafhauzen, njëherazi edhe bashkëthemeluesi i grupit shqiptar në kuadër të kësaj sindikate, i cili është aktiv dhe mban edhe funksione tjera në sektorin e ndërtimtarisë dhe të migracionit.

Ai të pranishmit i njoftoi shkurtë por me shumë përmbajtje mbi historinë dhe kontributin e grupit shqiptar për kushte më të mira pune e jetese në Zvicër, sikur edhe për pensionimin e parakohshëm me 60 vjeç në ndërtimtari, pa lënë anash edhe angazhimin e kontributin e tyre dhe të sindikatës Unia për ripërtëritjen e marrëveshjes për sigurimet shoqërore mes Zvicrës dhe Kosovës, një kontribut ky i çmuar për pensionistët e kthyer nga Zvicra në Kosovë dhe familjarët e tyre.

Më pas, moderuesja e tubimit ia dha fjalën edhe Violeta Ruoss, bashkëdrejtuese e Unia të regjionit Cyrih-Shafhauzen. Ajo në fjalën e saj foli ndër të tjera foli edhe për nevojën e shfrytëzimit e të gjithë atyre që kanë të drejtën për të bashkëvendosur, e drejtë kjo që ka të bëjë me kushtet e punës dhe jetesës edhe për gjeneratat e ardhshme. Një theks të veçantë ajo e vuri tek nevoja për të informuar njerëzit drejtë edhe se si votohet, pasi shumë njerëz me sfond migracioni



edhe nga pasiguria anashkalojnë pjesëmarrjen në votime, ku vendoset edhe për ta.

Prezantimi i argumenteve për votimin e me PO përkitazi me nismën sindikale për pensionin e 13 të pleqërisë dhe me JO të nismës pensionale për rritje të moshës së daljes në pension, u bë nga O. Osmani, pensionist aktiv dhe sindikalist shumëvjeçar shqiptaro-zviceran. Kolegët tjerë sindikal me këtë rast zhvilluan edhe intervista të shkurta prononcimi në mbështetje të fushatës për pensionin s 13 të AHV/AVS dhe kundër nismës për shtyrje të moshës së pensionimit.

### Diskutime me argumente për dhe kundër

Përderisa diskutimi në tubimin e Cyrihut më intensivisht u zhvillua gjatë koktejit

përmbyllës të tubimit, në atë të Uster zhvilluar në lokalet e shoqatës «Bashkimi» u zhvillua gjatë prezantimit dhe në diskutimin vijues, ku përpos nga bota e punës kishte edhe shqetësime e pyetje tjera mbi sigurinë e përgjithshme shoqërore. Dy anëtarët e kryesisë së shoqatës «Bashkimi» Guzimtar Alushi dhe Bekim Bajraktari gjatë diskutimit, përcollën më tej edhe qëndrimet reaguese të atyre që nuk kishin mundësi të merrnin pjesë në tubim dhe të cilat gjithashtu u diskutuan meritueshëm.

Këto dy tubime të rëndësishme në gjuhën amtare, që kanë të bëjnë me informimin e drejtë e të qartë mbi përmbajtjen e nismave votuese popullore dhe mbi mundësitë, obligimet dhe të drejtat e bashkëvendosjes u vlerësuan nga të pranishmit dhe tregoi nevojën për bashkëbisedime të tjera me tema të ndryshme me interes për komunitetin tonë.